



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 66/1 Prot.

Vlorë, më 27 .02. 2020

VENDIM

Nr. 66, datë 27.02.2020

PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR (KIZ)
NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE

Në zbatim të Urdhrit të Ministres së MASR, znj. Besa Shahini, nr. 8, datë 14. 01. 2020 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në IAL", shkronjës a të pikës 1 në nenin 6 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, Vendimit të Senatit Akademik nr. 63, datë 18.02.2020 "Për çeljen e procedurave për ngritjen e Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ) në UV" dhe nenit 18 dhe 19 të Rregullores së SA, Senati Akademik në mbledhjen e datës 27. 02. 2020

VENDOSI:

1. Të miratojë, pas votimit të të vetëkandiduarve për anëtarë të Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ), përbërjen e tij, UV si më poshtë:

Shkëlqim Sinanaj, personel akademik, Fakulteti i Ekonomisë;
Oljana Hoxhaj, personel akademik, Fakulteti i Shkencave Humane;
Eljona Zanaj, personel akademik, Fakulteti i Shkencave Teknike;
Evis Allushi, personel akademik, Fakulteti i Shëndetit Publik;
Kristi Mucollari, student, Fakulteti i Shkencave Teknike;
Belinda Halilaj për pozicionin e **Sekretarit** të KIZ, personel akademik, Fakulteti i Shkencave Humane.

2. Menjëherë pas shpalljes nga ana e Kryetarit të SA, ky vendimi i vihet në dispozicion secilit prej anëtarëve të KIZ, të zgjedhur në këtë mbledhje.

3. Menjëherë pas shpalljes nga ana e Kryetarit të SA, ky vendimi i vihet në dispozicion sekretarit të KIZ, të përzgjedhur në këtë mbledhje.

4. Anëtarët e Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ), pas marrjes së këtij njoftimi, në mbledhjen e parë, më të afërt, zgjedhin kryetarin, konform pikës f të nenit 6 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, dhe më pas të vijnë veprimtarinë mbi bazën e kësaj rregulloreje.

5. Ky vendim iu komunikohet të gjithë studentëve, Asamblesë së personelit akademik, autoriteteve drejtuese dhe organeve kolegjiale të UV.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. **Koland ZISI**

